



**Instituti Kombëtar Demokratik (NDI)
PËR PUBLIKIM TË MENJËHERSHËM
21 Mars 2012**



KOMUNIKATË PËR MEDIA JAVA E GRUAS NË KOSOVË 2012

PRISHTINË — Për herë të parë në Kosovë, 100 gra përfaqësuese të partive politike, Kuvendit të Kosovës, qeverisë, nga akademia, shoqëria civile dhe nga biznesi u mbledhën së bashku për një javë për të diskutuar dhe identifikuar mundësitë që do të ndihmojnë gratë të jenë më efektive dhe më të suksesshme në fushën e tyre të zgjedhur.

Panelist të ditës së dytë Gratë dhe Ekonomia ishin: Mimoza Kusari, Zv.Kryeministre/ Ministre për Tregti dhe Industri. Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Edona Hajrullahu, Kryeshefe e Agjencisë për Barazi Gjinore në ZKM. Laura Kryeziu, Menaxhere e programit Hope Felloëships. Mimoza Godanci, Zv Drejtore Ekzekutive e ProCredit Bank në Kosovë. Cathy Allen, Presidente e Connections Group. Nikoqire: Donika Kadaj Bujupi, Deputete e Kuvendit të Kosovës.

Donika Kada Bujupi Deputete e Kuvendit të Kosovës në fjalimin hyrës potencoj sfidat dhe vështirësitë në fushën e bizneseve, sfida keto për të dy gjinitë mirëpo për gratë sfidat bëhen më të mëdha. “Ne kemi gra në biznese të ndryshme, sfidë me e madhë gjithmonë për ato është plasimi i produkteve apo shërbimeve të tyre në treg” tha ajo.

Mimoza Kusari Zv.Kryeministre dhe Minstre e Tregtisë përgëzoj gratë deputete për aktivitetet e shumta të cilat ato janë duke bërë për të përmirësuar pozitën e gruas në shoqëri. Ndërsa sa i përket pengesave që karakterizojnë gruan në biznes Zv.Kryeministrja potencoj perceptimin e përgjithshëm për gruan në biznes, me paragjykimet se ajo nuk do t’ja del kurrë. “Gruaja duhet t’i thej ato barriera mandej të ballafaqohet me barrierat tjera për të arritë barazinë gjinore në biznes”

Safete Hadërgjonaj njëra nga dy gratë që udhëheqin Komisionet Parlamentare në këtë rast Komisioni për Buxhet dhe Financa tregoj për punën që Kuvendi duhet bërë për paraqitjen e Buxhetimit Gjinor kur bëhen strategji dhe aprovohen buxhete . Buxhetim i tillë është favorizuar nga BE-ja, Parlamenti Evropian me miratim të rezolutave për Buxhetim Gjinor.

“Buxhetimi gjinor nuk i përket vetëm femrës por të dy gjinive”, tha ajo.

Laura Kyreziu nga Hope Fellowship – Gjendja ekonomike është gjendje e përbashkët tha ajo, mirëpo femra prapë është më e diskriminuar. “Statistikat janë marramendese. Statistikat e papunësisë në Kosovë tani janë 43% të papunë, nga kjo përqindje 55% e të pa punëve janë femra” tha znj. Kryeziu.

Nga Sektori privat vetëm 2% kredi për biznese i takojnë grave dhe vetëm 6% janë femra pronare të bizneseve. Numri i ulët i kredive është rezultat i mos shpërndarjes së trashëgimisë barabartë mes femrës dhe mashkullit në familje edhe pse ligji e rregullon një gjë të tillë.

Cathy Allen presidente e Connection Group tha që jo shumë gra hynë në biznes, në ato biznese ku ofrohen shërbime si ato teknologji, auditim, dhe në planifikim strategjik të cilat tani janë trend botëror. “Çdo grua duhet të jetë së paku njëherë në jetë grua në biznes”.

Java e Gruas 2012 filloj më 20 Mars dhe do të përfundoj me 24 Mars në Prishtinë. Dita e dytë, Gratë dhe Ekonomia u mbajt sot. Dita e 3 dhe 4 do të mbahet në Universitetin Amerikan të Kosovës. Dita e pestë do të përmbillet me një ceremoni në Hotelin Sëiss Diamond.

Temat e kësaj jave do të jenë: Gratë në Lidërsip; Gratë ne Ekonomi; Gratë në Politikë dhe Shoqëri Civile dhe Gratë në Media.

NDI në vitin 2010 me një aktivitet një javorë ndihmoj gratë kandidate për Zgjedhjet 2010 në mënyrë që gratë të kenë shkathtësitë e nevojshme për të kandiduar. Këtë vit, NDI në bashkëpunim me Grupin e Grave Deputete kanë bashkëpunuar për të zgjeruar një aktivitet të ngjashëm për gratë e ardhshme lidere.

Pjesëmarrëse të kësaj ngjarje janë Këshillatë te Kuvendit Komunal; Deputetet e Kuvendit të Kosovës; aktivistë të partive politike, gratë që planifikojnë të kandidojnë, profesorë, studentë, gra në biznes dhe nga shoqëria civile dhe përfaqësues nga media. Pjesëmarrësitë e kësaj ngjarje do të përfaqësojnë gjithë rajonet e Kosovës, me përbërje ndëretnike dhe nga gjenerata të ndryshme.

Për më shumë informata për Javën e Gruas ju lutem kontaktoni Arta Qorri në aqorri@ndikv.org apo ne nr. e telefonit +377 44 170 703. Facebook Kosovo Women’s Week 2012: <http://www.facebook.com/pages/Java-e-Gruas-Week-of-Women-Nedelja-Zene-2012/192559664187104>

Website: www.weekofwomen.org

###

NDI punon në Kosovë që nga viti 1999 drejt ndërtimit të institucioneve dhe qeverisje demokratike dhe transparente. Programet e NDI në Kosovë përfshijnë fuqizimin e legjislativit, zhvillimin e partive politike dhe pjesëmarrjen qytetare dhe në pjesë të madhe financohen nga Populli Amerikan përmes Agjensionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).